




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu



Nr. l prot 179 Më 20.01 2020  
Br. prot. Dt. 20.01 2020  
RAHOVEC - ORAHOVAC

KOMUNA  
**RAHOVEC**

JANAR DHJETOR 2019

# RAPORTI VJETOR I PUNËS



## DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike, në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, Planit të Punës për vitin 2019, përkundër sfidave dhe vështirësive ka përfunduar me sukses një sërë projektesh dhe ka realizuar një mori aktivitësh përgjatë kësaj periudhe njëvjeçare, në vazhdim DSHP ka raportuar në baza tremujore mbi thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

### Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

- Pas reshjeve të mëdha të borës në të gjithë territorin e komunës sonë, kemi pasur angazhime me dy kompanitë e kontraktuara nga Komuna e Rahovecit që vazhdimisht ishim në dispozicion të plotë në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes dimërore të rrugëve;
- Kemi caktuar zyrtarin për efikasitet që do të kujdeset më shumë me grupin tjetër punues të Komunës, që në bashkëpunim me organizatën Gjermane GIZ, kanë krijuar databasën për mbledhjen e informatave të mjaftueshme në terren, në mënyrë që të dalim me raporte të sakta për gjendjen e objekteve institucionale në Komunën tonë;
- Ka vazhduar projekti për furnizim me gypa nga PVC dhe projekti për intervenime emergjente gjatë vitit 2019. Kanë përfunduar punimet në projektin “Ndërtimi i trotuarëve” në Drenoc, Malësi të Vogël, Sapniq si dhe në rrugën rajonale në fshatin Çifllak.

### Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

- Janë nënshkruar marrëveshjet e bashkëfinancimit nga Ministria e Infrastrukturës me Komunën e Rahovecit për të investuar në disa projekte që kapin shifrën mbi 1.5 milion €. Ndërtimi i rrugës Rahovec- Hamoc- Fortesë dhe ndërtimi i rrugës Xërxë-Sapniq-Ratkoc, këto dy projekte tashmë kanë filluar dhe është bërë hapja e trasesë së rrugës;
- Janë përfunduar një mori segmente rrugore të ndriçimit publik, si: Segmenti prej 2 km i ndriçimit publik në Xërxë dhe në pjesën më të madhe të fshatit, janë përfunduar 3 rrugë kryesore të ndriçimit publik të lagjeve në qytet, segmenti i rrugës kryesore në Ratkoc në gjatësi prej 1.4 km, ndriçimi publik në varrezat e fshatit Hoçë e Vogël, ndriçimi në Dejnë në rrugën kryesore, vlen të theksojmë se me vet iniciativa tjera vullnetare të banorëve të fshatit Dejnë janë ndriçuar edhe 7 segmente rrugore, vazhdojnë punimet në Malësi Vogël;
- Kemi filluar me dy projekte të trajtimit të kanalizimeve në komunën tonë dhe deri më tani llogaritet projekti më i madh i trajtimit të ujërave fekale, që prin me qytetin e Rahovecit, pastaj edhe në 16 vendbanime të tjera, janë rehabilituar disa degëzime të kanalizimeve në Ratkoc, është përfunduar një lagje në Celinë, vazhdon projekti sipas prioriteteve edhe në vendbanime të tjera;
- Janë bërë disa ndërhyrje emergjente në kanalizimin e ujërave fekale në Vrajakë;

- Gjatë muajit prill, kemi mbajtur takim me të gjithë pronarët e shfrytëzuesve të garazheve publike, ku do të merren të gjitha masat dhe do të bëhet një verifikim i hollësishëm që këto garazhe të marrin epilog, që mos të mbesin si prona të pa shfrytëzuara;
- Ka vazhduar projekti në mirëmbajtjen e hapësirave publike, pastrimi i varrezave si dhe pastrimi i lapidarëve dhe varrezave të dëshmorëve, në tërë Komunën tonë;
- Ka vazhduar projekti ndërtimi i mureve mbrojtëse në komunën tonë, është duke u realizuar ndërtimi i murit në fshatin Krushë e Madhe, lagja e komuniteteve;
- Është përfunduar projekti në ndërtimin e murit mbrojtës të ri tek varrezat e qytetit, dhe pritjet të përfundojë projekti në tërësi i rrethrotullimit;
- Është shpallur projekti i ndërtimit të tre udhëkryqeve të rinjë, me semaforët e rinj;
- Në muajin maj 2019, është lidhur një marrëveshje mirëkuptimi në mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Rahovecit për projektin më të madh të komunës sonë, “Rruga 4 korsi Rahovec-Xërxë”;
- Ka përfunduar asfaltimi i rrugës tranzite mbi qytet si dhe është bërë kategorizimi i rrugës ku ka kaluar në menaxhim të MIT si rrugë rajonale;
- Ka përfunduar asfaltimi i rrugës Krushë e Madhe-Randobravë.

### **Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator**

- Në bashkëpunim me zyrtarë nga KRU Gjakova kemi arritur të finalizojmë disa projekte për furnizim me ujë të pijshëm, është përfunduar projekti për ujë pijshëm për Baboc, jemi në përfundim edhe për fshatin Pastasel;
- Punimet janë zhvilluar në infrastrukturë publike si në; Ndriçim publik, është ndërtuar parkingu i ri afër Stacionit Policor në Rahovec etj;
- Jemi angazhuar gjatë vitit 2019 me aksione të një pas njëshme në pastrimin e hapësirave publike, ka pasur aktivitet për heqjen e deponive inerte në komunën tonë, në kuadër të projektit për intervenime emergjente, ka vazhduar projekti për pastrimin e rrugëve nga mbeturinat, ka vazhduar puna në mirëmbajtjen e varrezave, rreth rrotullime, në hapësira publike, larja e rrugëve, varreza të dëshmorëve, lapidarëve e kështu me radhë, në të gjitha vendbanimet janë bërë pastrimet;
- Kemi nënshkruar dy marrëveshje mirëkuptimi për projekte ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe MAPL-së: Trajtimi i Kanalizimeve dhe Ndriçimi Publik, si projekte të fituara (grande) në kuadër të performancës komunale, vlera e grandit është 60,000.00 euro;
- Në bashkëpunim me GIZ-in Gjerman kemi krijuar databazë për eficiencë të energjisë, tashmë ka përfunduar drafti i planit 5 vjeçar dhe ka kaluar në Kuvend të Komunës;

## Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

- Janë filluar dy segmente rrugore, si projekte të mbështetura nga MIT: Ndërtimi i rrugës Rahovec-Hamoc-Fortesë si dhe në rrugën Xërxë-Sapniq-Ratkoc, si dhe segmenti Sapniq-Nushpal;
- Në bashkëpunim me dy kompanitë për mbledhjen e mbeturinave jemi duke bërë pastrimin e rrugëve të qytetit dhe rrugëve kryesore të vendbanimeve;
- Kanalizimet fekale, projekt me bashkëfinancim me MPAPL, kemi vazhduar punimet në rrjetin e kanalizimit në fshatin Kramavik, në fshatin Mrasor, pastaj ka vazhduar me një degëzim në Senoc si dhe në disa lagje të Rahovecit do të intensifikojmë punimet;
- Kemi filluar me projektin për parkingjet e reja në qytet;
- Suksesi më i madh i DSHP-së për vitin 2019 ka qenë lidhja e kontratës së projektit "Ndërtimi i rrugës 4 shiritor (korsi) nga Rahoveci në Xërxë", që njihet projekti më i madh deri më tani në komunën tone. Tashmë Policisë së Kosovës, Stacioni Policor në Rahovec, ju kemi ofruar shërbimet me kontratë me kompaninë për autobartje të veturave.

### Sfidat e DSHP-së:

- Te adresuara kërkesa për rrjete të reja të kanalizimit, ndërtimit të rrugëve lokale, kërkesa për rrugë dytësore dhe të pa kategorizuara;
- Kërkesa për mirëmbajtjen e përroskave dhe kanaleve që gjenden në vendbanime dhe në lagjet urbane;
- Kërkesa të vazhdueshme për ndriçim publik në të gjitha vendbanimet;
- Kërkesa të vazhdueshme për ndërtim të trotuarëve, në shumë vendbanime të Komunës sonë;
- Sfidë e radhës që vazhdimisht na ka përcjellur gjatë vitit 2019 janë mbeturinat e amvisërisë që fatkeqësisht hidhen kudo, vend e pa vend, ku krijohen deponi ilegale;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë ujë të pijshëm (Pastasel, Kaznik dhe Zatriq);
- Pas reshjeve të shumta gjatë muajve maj dhe qershor, sfidë mbetet trajtimi i ujërave atmosferikë në rrugët kryesore të qytetit;
- Në Drejtorinë e Shërbimeve Publike janë adresuar mbi 600 kërkesa të ndryshme gjatë vitit 2019, 230 të apovuara, 138 të refuzuara, 56 kanë qenë në proces si dhe 40 janë ceduar, të tjerat kanë të bëjnë me investimet publike nga operatorë të ndryshëm!

## PËRFUNDIM

*Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.*


*Raporti i punës për vitin 2019 është dëshmi e respektit ndaj Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe i dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.*

*Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë përditë e më mirë punën tonë.*

20.01.2020

Rahovec



PËRPARIM KRASNIQI  
  
DREJTOR I DSHP-së